



Datë: 05.05.2026

A.nr.1986/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1986/2025, të datës 04.12.2025, të parashtruar nga ankuesja F.S, të cilën me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokateve Sejdiu & Qerkini, Prishtinë, kundër Vendimit me numër të protokolli 10523, të datës 12.11.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1986/2025, e datës 04.12.2025 e parashtruar nga ankuesja F.S.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 10523, i datës 12.11.2025, i ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

A r s y e t i m

Ankuesja F.S (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 20.11.2025, përmes postes kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 04.12.2025 dhe e regjistruar nën shenjë A.nr.1986/2025, kundër Vendimit me numër të protokolli 10523, të datës 12.11.2025, të ushtruesit të detyrës të Sekretarit të Përgjithshëm, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (*tutje referuar MMPHII*), ndërsa, kjo e fundit, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto

prova: Ankesën me numër protokollit 1986/2025 të datës 04.12.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.12.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 10.12.2025; Akt Emërimit të datës 27.10.2011; Vendimin me numër të protokollit 10523 i datës 12.11.2025; Kronologjinë e emailave të datës 06.11.2025 dhe 23.10.2025 lidhur me informim për ngritje të aktakuzës.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, *sepse:*

Gjendja e fakteve

Nga provat e administruara rrjedhë se:

-Ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, tani Ministria e Infrastrukturës dhe së e njëjta sipas Aktit të Emërimit të datës 27.10.2011, është e punësuar në pozitën Inspektore e Auto shkollave, Departamenti i Inspektoratit.

- Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MMPHI, më datë 23.10.2025 i është drejtuar më kërkesë (përmes emailit zyrtar) Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me njoftimin se procedura lidhur më zyrtaret F.S, E.Q dhe V.V, është duke u zhvilluar në fazën e hetimeve apo është ngritur aktakuzë.

- Në përgjigje të kërkesës së MMPHI-së të datës 23.10.2025, Zyrtarja për Informim dhe Komunikim me Media pranë Gjykatës Themelore në Prishtinës, përmes emailit të datës 06.11.2025, ka njoftuar MMPHI-në se: ... *Referuar kërkesës tuaj për informata e cila ka të bëjë më rastin e zyrtarëve të MMPHI-së, nga gjyqtari i çështjes jemi njoftuar se, Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda, më datë 03.10.2025, ka ngritur aktakuzë për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 në lidhje me nenin 31 të Kodit penal të Republikës së Kosovës (KPRK).*

-Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI-së më datë 12.11.2025 ka nxjerrë Vendimin me numër të protokollit 10523, për pezullim të ankueses nga marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare nga data 07.11.2025, dhe atë me kompensim të pagës deri në pesëdhjetë (50 %) deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër.

Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin me numër të protokollit 10523, të datës 12.11.2025, të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI, më pretendimet ankimore se vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 539 të Kodit të Procedurës Penale Nr.08/L-032, sepse kompetencat për pezullim të personit zyrtar ka kaluar në gjykatë sipas kërkesës se arsyetuar nga

prokurori i shtetit, pra, nuk mund të ketë pezullim të personit zyrtar pa kërkesë të prokurorit dhe pa një vendim të gjykatës. Shton se Ligji për zyrtarët publikë bie ndesh me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, kështu që duhet të respektohet parimi “lex specialis” dhe parimi i ligjit me të favorshëm për palën. Kërkon që ankesa të konsiderohet e bazuar.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit në kuptim të bazushmërisë së pretendimeve ankimore i’u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, që rregullojnë çështjen e pezullimit të marrëdhënies së punës së nëpunësit civil, me theks të veçantë:

-Nenit 37, paragrafi 1 dhe 2 [Marrëdhënia e punës në shërbimin civil], ku përcaktohet se: 1. *Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji.* 2. **Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj.**

-Nenit 68 paragrafi 1 [Llojet e pezullimit] 1. *Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil që bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; 1.2. me kërkesë të nëpunëses/it civil.* 2. *Gjatë periudhës së pezullimit, marrëdhënia e shërbimit civil nuk mund të përfundojë dhe nuk mund të ndryshojë, përveçse me kërkesën e nëpunëses/it të pezulluar ose kur parashikohet shprehimisht me këtë ligj.* 3. *Nëpunëses/it civil i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga puna dhe marrëdhënia e punës gjatë periudhës së pezullimit, përveç të drejtës për tu kthyer në vendin e punës, sipas këtij ligji.*

-Nenit 69, paragrafi 1 dhe 2 [Pezullimi sipas detyrës zyrtare] ku përcaktohet se: 1. *Nëpunësja/i civil pezullohet sipas detyrës zyrtare, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 4. të nenit 59 të këtij ligji; 1.2. kur emërohet në një nga funksionet e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 3 të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit; 1.3. transferohet, për nevoja të institucionit, në një organizatë ndërkombëtare apo në një institucion ndërkombëtar, për periudhën përkatëse; 1.4. kur gjykata pezullon nëpunësen/in civil që është person zyrtar nga ushtrimi i detyrës, për kushtet dhe shkaqet të parapara në legjislacionin përkatës në fuqi; 1.5. ndaj nëpunëses/it civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj/tij;*

-Nenit 71, paragrafët 1, 8, 9 *Pas përfundimit të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, sipas këtij ligji, nëpunësja/i civil rikthehet në pozitën e mëparshme të punës. ..8. Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1., nën-paragrafët 1.4., 1.5., 1.6. dhe 1.7. të nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civile përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, deri në fund të periudhës së pezullimit.* 9. *Në rast se procedura disiplinore apo procedura penale përfundon pa një masë disiplinore, gjegjësisht dënim penal, nëpunëses/it civil që ka qenë e pezulluar me pesëdhjetë për qind (50%) të pagës së saj/tij, i kompensohet pjesa e ndaluar e pagës bazë”.*

Rrjedhimisht, neni 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe paragrafi 2 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është ndryshuar më nenin 13 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik, me të cilin është përcaktuar: *1. Në nenin 69, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.5. të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1.5. ndaj nëpunësit civil është ngritur aktakuzë për procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij. 3. Paragrafi 2. i nenit 69 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 2. Përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj, konstatimi i shkakut të pezullimit bëhet me vendim nga: 2.1. Zyrtari më i lartë administrativ i institucionit ku nëpunësi ushtron detyrën.*

Referuar përcaktimit ligjor si më sipër, Kolegji i Këshillit ka analizuar aktin e kontestuar në ndërlidhje edhe më provat materiale të çështjes, ku si rrjedhojë konstatoi së pezullimi i ankueses nga marrëdhënia e punës është zbatuar si pasojë e faktit së ndaj ankueses është ngrit aktakuzë për shkak të veprës penale “ keqpërdorim i autoritetit apo detyrës zyrtare”, kështu që, mbi këto rrethana, Kolegji vlerëson së Vendimi me numër të protokolli Nr.10523, i datës 12.11.2025, i u.d Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së është nxjerrë në pajtim me dispozita materiale si më lartë, sepse, sipas shkresës zyrtare të përcjell nga Gjykata Themelore në Prishtinë konfirmohet së Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, më datë 03.10.2025, ka ngritur aktakuzë ndaj ankueses për veprën penale “ keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Në këtë kontekst, Kolegji thekson faktin së në çdo rast kur ndaj një nëpunësi civil është ngrit aktakuzë për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, atëherë, organi punëdhënës sipas detyrës zyrtare duhet të bëjë pezullimin e zyrtarit, rrjedhimisht, vet fakti i ngritjes së aktakuzës për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare përbën fakt ligjor dhe *ex lege* zyrtari duhet të pezullohet nga marrëdhënia e punës.

Lidhur me pretendimin se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me dispozitat e nenit 539 të Kodit të Procedurës Penale, sepse, nuk mund të ketë pezullim të personit zyrtar pa kërkesë të prokurorit dhe pa një vendim të gjykatës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankuesja mban pozitë të nëpunësit të shërbimit civil, andaj, marrëdhënia e punës së nëpunësit civil përfshirë themelimin, ndryshimin dhe përfundimin i nënshtrohet rregullimit ligjor sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, e mbi këtë bazë është zbatuar edhe instituti i pezullimit në rastin konkret. Rrjedhimisht, pezullimi më vendimin të gjykatës përfaqëson shkak tjetër ligjor për pezullim sipas detyrës zyrtare siç përcaktohet me nenin 69 paragrafi 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kështu që, pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk gjen mbështetje ligjore.

Përmbledhur si më lartë, dhe duke u nisur nga fakti se ndaj ankueses është ngrit aktakuzë për vepër penale të kryer gjatë ushtrimit të funksionit/detyrës së tij/saj zyrtare, Kolegji i Këshillit konstaton se pezullimi i ankueses nga marrëdhënia e punës sipas Vendimit më numër të protokolli Nr.10523, të datës 12.11.2025, të u.d Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, është bërë në përputhje me ligjin material, andaj, Kolegji vlerëson se vendimi i kundërshtuar më ankesë është i ligjshëm, kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.1986/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Shoqërisë së Avokateve Sejdiu & Qerkini, Prishtinë;
- MMPHI: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Personelit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.